



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin

PROCESVERBAL

Tiranë, më 09.07.2019, ora 11:00

Drejton mbledhjen:

Niko Peleshi – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

1. Shqyrtimi i projektligjit "Për ratifikimin e marrëveshjes së huas të lidhur ndërmjet Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, në cilësinë e huamarrësit, Fondit Shqiptar të Zhvillimit, në cilësinë e agjencisë së zbatimit të projektit, dhe KfW Frankfurt Am Main, për financimin e programit të furnizimit me ujë të zonave rurale IV" (*Komision për dhënie mendimi*)

2. Shqyrtimi i projektligjit "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.10 006, datë 23.10.2008, "Për mbrojtjen e faunës së egër", të ndryshuar"". (*Komision përgjegjës*)

Marrin pjesë:

Niko Peleshi, Halil Jakimi, Besnik Baraj, Halit Valteri, Ilir Beqaj, Rrahman Rraja, Eglantina Gjermani, Andrea Marto, Tatiana Nurçe, Ilir Ndraxhi, Arben Pëllumbi, Robert Bitri, Ardit Konomi, Dritan Bici, Halil Jakimi, Arlind Çaçani, Nimet Musaj, Zef Shtjefni, Kujtim Gjuzi, Ilir Pendavinji dhe Vullnet Sinaj.

Mungojnë:

Gjetan Gjetani dhe Lefter Koka.

Të ftuar:

Brikena Nastini – specialiste pranë Drejtorisë së Borxhit në Ministrinë e Financave

Leonard Miloti – përfaqësues nga Fondi Shqiptar i Zhvillimit

Elvana Ramaj – përfaqësuese nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit

HAPET MBLEDHJA

Niko Peleshi – Mirëmëngjesi!

Fillojmë mbledhjen e Komisioni për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin.

Sot kemi për shqyrtim projektligjin "Për ratifikimin e marrëveshjes së huas të lidhur ndërmjet Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, në cilësinë e huamarrësit, Fondit Shqiptar të Zhvillimit, në cilësinë e agjencisë së zbatimit të projektit, dhe KfW Frankfurt am Main, për financimin e programit të furnizimit me ujë të zonave rurale IV". Relator është zoti Arben Pëllumbi.

Të ftuar kemi zonjën Brikena Nastini, specialiste pranë Drejtorisë së Borxhit në Ministrinë e Financave dhe zotin Leonard Miloti nga Fondi Shqiptar i Zhvillimit.

Në fillim fjalën do t'ia kaloj zotit Pëllumbi dhe pastaj do të kalojmë te pyetjet, përgjigjet dhe komentet.

Ju lutem, zoti Pëllumbi, na bëni një prezantim të shkurtër.

Arben Pëllumbi – Faleminderit, zoti kryetar!

Ne po shqyrtojmë projektligjin "Për ratifikimin e marrëveshjes së huas të lidhur ndërmjet Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, në cilësinë e huamarrësit, Fondit Shqiptar të Zhvillimit, në cilësinë e agjencisë së zbatimit të projektit, dhe KfW Frankfurt Am Main, për financimin e programit të furnizimit me ujë të zonave rurale IV", të cilin javën e kaluar e shqyrtuam në komision dhe e ratifikuam në Kuvend, ndërsa sot do të futemi më në detaje, duke përcaktuar agjencinë e zbatimit të projektit dhe termat financiarë të saj.

Pra, bëhet fjalë për financimin e projektit IV, i cili ka të bëjë me investimet në ujësjellësin e Bashkisë Himarë e fshatrave përreth dhe në Bashkinë e Vlorës, kryesisht në zonën e Orikumit për përfundimin e investimit të bërë për impiantin e ujërave të zeza. Vlera e gjithë këtij projekti shkon rreth 45,1 milionë euro, ku 40 milionë euro do të financohen nga kjo marrëveshje.

Siç u diskutua edhe javën e kaluar, për grantin prej 2 milionë eurosh, buxheti i shtetit do të paguajë 1,35 milionë euro, ndërsa 1,8 milionë euro, që mbyll të gjithë paketën, do të financohen nga një grant i akorduar nga korniza e investimeve të Ballkanit Perëndimor.

Kredia prej 40 milionë eurosh do të ketë një normë fikse, e cila do të përcaktohet në momentin e bërjes efektive të huasë, por nga praktikat e deritanishme dhe në marrëveshjen mes dy qeverive kjo nuk i kalon 2%, pra do të jetë midis 1 dhe 2%. Tarifa e menaxhimit është

1%, tarifa e angazhimit është 0,25% dhe maturimin është për 15 vjet, ku 3-vjeçari i parë është pa pagesë principale. Praktikisht kjo është formula në kuadër të marrëveshjeve që bëhen me KfW-në.

Duke pasur parasysh se kjo marrëveshje është e rëndësishme për Jugun e Shqipërisë, pra furnizimi me ujë i këtyre zonave dhe përfundimi i projektit të ujërave të zeza për zonën e Orikumit do të ketë një ndikim shumë të madh jo vetëm në aspektin e zhvillimit turistik të vendit, por edhe në përmirësimin e shëndetit publik, ambientit dhe faunës në atë zonë, unë ju ftoj të gjithëve që ta votojmë këtë projektligj.

Faleminderit!

Niko Peleshi – Faleminderit, zoti Pëllumbi!

A ka pyetje për përfaqësuesit e Fondit Shqiptar të Zhvillimit?

Po, zoti Sinaj.

Vullnet Sinaj – Faleminderit, zoti kryetar!

Burimi nga ku do të merret uji për projektin e zonës së bregdetit të Himarës është në Kuç të Vlorës dhe quhet Buronja, i cili është burimi kryesor i lumit Shushicë. Nga studimi i fizibilitetit që keni bërë në këtë burim sa përqind e ujit shkon për furnizimin e ujësjellësit dhe sa ngelet për lumin? A dëmtohen banorët e zonave përreth në vaditjen e tokave apo në blegtori?

Niko Peleshi – A ka pyetje të tjera? Nuk ka.

Po, ju lutem.

Leondard Miloti – Faleminderit, zoti kryetar!

Nga studimi i fizibilitetit, i cili është hartuar vitin e kaluar nga kompania konsulente, në periudhën më të thatë, pra në shtator – tetor, ka rezultuar që sasia e prurjes në burim është 660 litra në sekondë, ndërsa nevoja për furnizimin me ujë është 137 litra në sekondë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po, mbi 20%. Kjo është për periudhën më të thatë.

Niko Peleshi – Po, zoti Sinaj.

Vullnet Sinaj – Shpresoj të jetë kështu siç thotë përfaqësuesi i Fondit të Zhvillimit, sepse unë jam deputet në atë zone dhe e di shumë mirë se sa problem janë prurjet e lumit në muajin gusht. Por ajo që më shqetëson është se në projektin për Bashkinë e Himarës janë përjashtuar katër fshatra, të cilat ndodhen afër burimit. Pra, në këtë projekt nuk futen këto fshatra: Kallarati, Vranishti, Tërbaçi dhe Bolena, të cilat ndikohen drejtpërdrejt në vaditjen e tokave.

Për mua, si deputet i asaj zone, nuk është normale që të bësh një projekt për ujësjellësin e të gjithë zonës së Himarës, ku uji merret në zonën e Labërisë, pra nga lumi i Vlorës, dhe këto katër fshatra që janë afër burimit të lihen jashtë, me përjashtim të Kuçit, i cili është fshati ku do të bëhet ujësjellësi.

Zoti kryetar, unë kërkoj nga ju si kryetar i Komisionit të Veprimtarisë Prodhuese të kërkonte që në projekt të përfshihen edhe këto katër fshatra.

Faleminderit!

Niko Peleshi – Po, zoti Miloti.

Leondard Miloti – Nuk kam ndonjë shpjegim, por për këtë projekt është diskutuar gjatë me bashkinë dhe këto kanë qenë prioritetet e bashkisë për zonën turistike.

Niko Peleshi – Sa mundësi ka të bëhet ndonjë adoptim apo shtesë?

Leondard Miloti – Me informacionin që kemi për të përfshirë edhe fshatra të tjera në këtë marrëveshje, është e pamundur, sepse kërkon një periudhë shumë të gjatë diskutimesh. Por Fondi ka edhe projekte të tjera, të cilat janë financime të qeverisë shqiptare e donatorëve të tjerë, dhe unë mund t’ia parashtroj kërkesën drejtorit ekzekutiv.

Niko Peleshi – Dakord, regjistrojeni edhe si kërkesë të komisionit. Pra, të shikohet mundësia edhe nga burime të tjera për një lloj balance me komunitetin dhe të përfshihen edhe këto katër fshatra.

Po, zoti Beqaj.

Ilir Beqaj – Në vijim të kësaj, a është kryer prokurimi?

Leondard Miloti – Prokurimi për dizajnin nuk është kryer, është në proces për përgatitjen e projektimit, i cili mendojmë se do të përfundojë në qershor të vitit të ardhshëm. Ne kemi realizuar vetëm fizibilitetin teknik.

Ilir Beqaj – Kur mendoni se mund të fillojnë punimet? Nga praktikat tuaja të mëparshme, nëse në prokurim ka kursime, çfarë ndodh me to, a i kthehen kredidhënësit?

Leondard Miloti – *(mungesë incizimi)* ... të tjera të ujësjellësit.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Niko Peleshi – Ne si komision japim këtë sugjerim.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ju lutem, regjistrojeni si rekomandim, por ndërkohë edhe Elona do të përgatisë një shkresë në emër të komisionit, të cilën do ta firmos unë si kryetar drejtuar Fondit, ku të kërkohej që të gjitha tepricat apo kursimet që do të dalin nga procesi i prokurimit të këtij projekti të përdoren në fshatrat që kanë mbetur jashtë projektit, ku të përmendim edhe emrat e katër fshatrave.

Vullnet Sinaj – Jemi në fazën e një projekti dhe Fondi i Zhvillimit është duke financuar projektin e rrugës së lumit të Vlorës, i cili kushton mbi 100 milionë euro, dhe lëmë këto katër fshatra pa ujë, në të cilat, kur të ndërtohet rruga, parashikohet të zhvillohet turizmi malor. Pra është një zonë bletërritëse dhe mendohet që të ketë edhe një zhvillim të agrokulturës, “api terapia” dhe mund të ketë vizitorë të shumtë. Kjo zonë me rrugën e lumit të Vlorës, pra me lotin e fundit që është nga Ura e Laskos në Qeparo, lidhet me Himarën dhe për pushuesit është diçka më shumë, sepse, përveç bregdetit apo klimës bregdetare, mund të kalojnë nga një rrugë shumë të shkurtër, rreth 15 kilometër, në pjesën malore. Pra, më duket se studimi ka nevojë për t’u riparë te pjesa e fizibilitetit, krahas asaj që i merret uji, që është pronë, le të themi, e asaj njësie administrative, pra burimi është i asaj, sepse është njësi administrative e Horë-Vranishtit, nga e cila është shkëputur vetëm fshati Kuç dhe janë lënë fshatrat Kallarat, Tërbaç, Vranisht dhe Polenë.

Bie sy për keq edhe për banorët e asaj zone, por, njëkohësisht, nuk i shërben 100% qëllimit, turizmit, se themi: “Do të investojmë për 80 mijë banorë bashkë me pushuesit në bregdetin e Himarës, ku nga këta 80 mijë banorë, 40 mijë mund të kalojnë në pjesën e Lumit të Vlorës dhe në pjesën e Labërisë.

Nuk do të ishte normale që andej të kishim shtëpi me ujë, ndërsa këtej të kishim probleme me ujësjellësit. Mendoj se është e domosdoshme të bëjmë një kërkesë si komision.

Niko Peleshi – Zoti Sinaj, nuk e vë në dyshim që ju e njihni mirë zonën dhe mund të keni të drejtë, por, në qoftë se ne do të merreshim me saktësinë dhe cilësinë e studimit të fizibilitetit, si dhe do të kërkonim një ristudim e të tjera, nuk besoj se është racionale, pasi kështu do të vononim marrëveshjen, fondin e të tjera.

Më racionalja është ajo që vendosëm ose që diskutuam. Pra, t’i kërkojmë edhe në formë shkresore si komision Fondit të Zhvillimit që tepricat e prokurimit, dhe besoj që do të mjaftojnë, t’i riinvestojmë brenda rrjetit të fshatrave që përfshin ky burim. Po të merremi me goditjen e studimit të fizibilitetit, në kuptimin e gjetjeve të tij, sa profesionale kanë qenë, besoj që do ta vonojmë, do ta shtyjmë shumë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po pra, por...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po, zoti Baraj.

Besnik Baraj – Në vlerësimin tuaj, mund të jetë aproksimativ, a kërkon buxhet të madh përfshirja edhe e këtyre zonave? Ndoshta-ndoshta ne duhet të ngulim këmbë vërtet, aq mundësi sa kemi, qoftë ju si institucion, qoftë ne si komision, sepse shpeshherë ndodh që, kur

bëhen investime të kësaj natyre, zor se rikthehen dhe, meqenëse është në atë zonë dhe mund të ketë edhe lehtësi në investim për sa i përket vetë projektit kur po bëhet, ndërhyrjet mund të jenë me kosto më të vogël, sesa kur mbaron ky projekt dhe rifillon një projekt tjetër.

Leonard Miloti – Nga eksperiencia në lidhje me sistemet e ujësjellësve në zonat rurale, kjo varet, në radhë të parë, nga numri i popullsisë, por duke marrë parasysh faktin se ato janë zona pak të thella, ne kemi një shifër të përafërt që varion për një fshat me 700-800 banorë, rreth 600 mijë euro, pra në ato zona shkon një skemë që është totalisht e pavarur. Në qoftë se ka burimin e vet, nga vepra e marrjes deri te konsumatori, te matësi, ajo ka një kosto të përafërt, ndërsa në rastin e burimeve të Lëpushës burimet do të merren nga sistemi që është parashikuar dhe mund të ulet kjo kosto.

Nuk mund ta them saktësisht se sa është vlera, por jemi afërsisht te 600 mijë euro për fshat ose për skemë.

(Deputeti Beqaj ndërhyrje pa mikrofon.)

Por për një skemë.

(Diskutime në sallë)

Për Orikumin janë parashikuar 7 milionë, ku 5 milionë janë për impiantin e trajtimit të ujërave të ndotura, kurse 2 milionë janë për instalimin e matësve të ujit për konsumatorët (flas gjithnjë për studimin e fizibilitetit) për zonën e qytetit.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Niko Peleshi – Po, zoti Baraj.

Besnik Baraj – A mendoni se mund të krijoni sensibilitetet e nevojshme, si institucion, duke komunikuar me burimin e financimit, apo duhet ndonjë faktor tjetër në nivelin e Këshillit të Ministrave për këtë shqetësim?

Leonard Miloti – Unë besoj se kjo që u tha këtu dhe kjo shkresa që do të bëhet, do ta ndihmojë shumë procesin, pasi KfW-ja është shumë strikte në parimet e saj dhe e ka të vështirë për ta zgjeruar zonën ose për të ndryshuar *scope*-in, qëllimin e marrëveshjes. Megjithatë, unë besoj se kjo është brenda marrëveshjes dhe, nëse do të ketë kursime, me mbështetjen e qeverisë, do të ndërhyhet te KfW-ja dhe besoj se mund të arrihet.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Niko Peleshi – Po, zoti Beqaj.

Ilir Beqaj – E kam pyetje, në fakt. Thatë që rreth 2 milionë euro janë parashikuar për vendosjen e matësve në Orikum?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Por matësit nuk tarifohen pastaj...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Familjarëve ose mbajtësit të kontratës?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Leonard Miloti – Gjithnjë është parashikuar... Kjo ka qenë një nga pikat e suksesit, pra, përveç ujësjellësve që janë me gravitet, edhe lidhja e konsumatorëve, edhe instalimi i matësve, rrjeti i familjarëve deri te kufiri i pronës. KfW-ja këtë e ka kërkuar vazhdimisht, pra instalimi i matësve nuk është se financohet nga individët, por nga programi.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ilir Beqaj – Më falni, por pyetja ishte për Orikumin, jo për të gjithë projektin!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Orikumi nuk është më zonë rurale, sepse pallatet në Orikum janë kryesisht shtëpi të dyta.

Unë e kuptoj që ndoshta është i suksesshëm një projekt në një zonë rurale, ku zona është e shtetit dhe ti ia çon edhe matësin, investon projektin, por njerëzve, që kanë shtëpi të dytë në Orikum, nuk është normale t'u japim sahatin pa pagesë, ndërkohë që kemi nevojë në zona të tjera.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Zoti kryetar, në Orikum, ato janë pallate... Të gjitha janë shtëpi pushimi. Nuk është fshat që ai jeton atje dhe po ia çojmë...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jo, jo, më fal! Tani, aty u tha që në përgjithësi, se ky hyn te zhvillimi i zonave rurale dhe financuesi, me të drejtë, në vite ka parë që është i suksesshëm kur ia lidh edhe sahatin. Por në Orikum, i cili për mua nuk është më fshat, por qytet, sepse ndërtesat aty janë tetë, dhjetë kate, madje shumica e atyre që i kanë, janë shtëpi të dyta...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Banorët autoktonë...

Vetë Orikumi, more!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Leonard Miloti – Atëherë, pjesë e këtij projekti janë: Jonufër, Radhimë, Dukati fshat dhe Dukati i ri.

Ilir Beqaj – Por gjysma janë shtëpi të dyta ose...

(Deputeti Beqaj flet pa mikrofon.)

Leonard Miloti – Që të jemi të qartë, matësit janë edhe për pjesën urbane, pra jo vetëm për fshatrat.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Fshatrat Dukat, Radhimë, Jonufër po, por edhe pjesa urbane, e cila ka mangësi në rrjetin e shpërndarjes dhe në matës.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Më falni!

Matësit janë matësit kryesorë në hyrje të pallatit për zonën urbane, ndërsa për zonat rurale (për fshatrat që cituam) matësit janë individualë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Në qoftë se fokusohemi tek Orikumi, bëhet fjalë për t'ua hequr matësin poshtë pallatit, atë që është për të gjithë pallatin.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ne nuk ndërhyjmë në rrjetin e pallatit.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Deri te hyrja e pallatit.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Niko Peleshi – Sa mund të shkojë investimi për këto katër fshatra?

(Deputeti Baraj flet pa mikrofon.)

Për të katër fshatrat?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Këto janë pjesë e studimit të fizibilitetit, nuk mund ta çmontojmë studimin pjesë-pjesë dhe ta gjykojmë këtu, kështu që më racional se kaq nuk mund ta gjejmë dot. Sikur të llogarisim 10% kursime, mund të bëhen 4 fshatrat. Përtej kësaj, dalim jashtë fushës sonë të përgjegjësisë dhe hapësirës për të gjykuar. Nuk mund të futemi në studimin e fizibilitetit, të marrim një pjesë të tij dhe ta analizojmë më vete. Brenda këtij projekti jo, sepse kanë llogaritur që shtesa të jetë nga kursimet.

Leonard Miloti - Studimi ka përfunduar në tetor të vitit të shkuar.

Niko Peleshi- A ka diskutime të tjera? Nuk ka.

Kalojmë në votimin në parim. Kush është dakord me projektligjin? Kundër? Nuk ka. Abstenime? Nuk ka.

Miratohet.

Kalojmë në votimin nën për nën.

Neni 1. Pro? Kundër? Abstenime?

Miratohet.

Neni 2. Pro? Kundër? Abstenime?

Miratohet.

Kalojmë në votimin në tërësi të projektligjit. Pro? Kundër? Abstenime?

Miratohet.

Faleminderit!

Elona, nesër do të kemi përsëri mbledhje, bëni gati shkresën, t'ia nisim Fondit Shqiptar të Zhvillimit si rekomandim për përdorimin e kursimeve.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin

PROCESVERBAL

Tiranë, më 09.07.2019, ora 11:00

Drejton mbledhjen:

Niko Peleshi – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

Shqyrtimi i projektligjit “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.10 006, datë 23.10.2008, “Për mbrojtjen e faunës së egër”, i ndryshuar”. *(Komision përgjegjës)*

Marrin pjesë:

Niko Peleshi, Halil Jakimi, Besnik Baraj, Halit Valteri, Ilir Beqaj, Rrahman Rraja, Eglantina Gjermani, Andrea Marto, Tatiana Nurçe, Ilir Ndraxhi, Arben Pëllumbi, Robert Bitri, Ardit Konomi, Dritan Bici, Halil Jakimi, Arlind Çaçani, Nimet Musaj, Zef Shtjefni, Kujtim Gjuzi, Ilir Pendavinji dhe Vullnet Sinaj.

Mungojnë:

Gjetan Gjetani dhe Lefter Koka.

Të ftuar:

Elvana Ramaj – përfaqësuese nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit

Niko Peleshi – Kalojmë në pikën tjetër të rendit të ditës shqyrtimi i projektligjit “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.10006, datë 23.10.2010 “Për mbrojtjen e faunës së egër të ndryshuar”.

Relator është zoti Besnik Baraj. E ftuar është zonja Elvana Ramaj nga Ministria e Mjedisit dhe Turizmit.

Fillojmë me prezantimin e zotit Baraj, pastaj me pyetje përgjigje për përfaqësuesen e ministrisë.

Besnik Baraj – Faleminderit!

Ky projektligj synon të transpozojë dy direktiva të Bashkimit Europian në lidhje me këtë sektor. Pa dyshim kjo është pjesë e procesit ku ne jemi futur dhe ka një rëndësi të veçantë. Unë do të doja të përqendrohem te problematikat që edhe këshilltarët tanë në komision kanë ngritur me këtë projektligj.

Së pari, projektligji ndryshon pjesën më të madhe të ligjit. A do të ishte më mirë që të kishim një ligj të ri?

Së dyti, nenet janë shkruar në gjuhën e direktivave, kanë karakter deklarativ, gjë që nuk përputhet me parimet e qartësisë, saktësisë dhe ekonomisë së ligjit.

Së treti, relacioni që shoqëron projektligjin është shumë i varfër në argumentimin e ndryshimeve dhe nuk jep asnjë informacion ose argument përveçse përsërit formulimet e bëra në projektligj.

Së katërti, projektligji përmend disa zona me interes për Komunitetin Europian për të cilat nuk jep as përkufizimin e tyre, as autoritetin që i përcakton dhe shpall këto zona.

Procesi i inventarizimit, është një element shumë i rëndësishëm, aq më tepër kur ne kemi ndërmarrë një masë ligjore, kemi ndaluar gjuetinë. Në kohën kur është bërë kjo ndalesë, ka qenë një porosi e komisionit të bëhej censusi i faunës, megjithëse në ligjin e mëparshëm dhe në këtë bëhet fjalë për speciet e rrezikuara dhe detaje e hollësira që vështirë arrin t’i bëjë ministria. Do të doja të dija nga ana juaj a është bërë ky census? Nëse ka filluar, a është census shkencor dhe kush është përfshirë në të? Unë do të thosha që në ligj të jetë i pasqyruar intervali i kohës në të cilin bëhet censusi i faunës. Është pa sens të flasim për specie të rrezikuara pa ditur ne sa kemi në magazinën tonë. A është bërë inventari i këtyre shpendëve? Asnjëherë nuk do të ishte shkencor përkufizimi i specieve të kufizuara pa të.

Sa i përket lidhjes së institucioneve shkencore në këtë lloj aktiviteti duhet përcaktuar patjetër që bëhet fjalë për universitetet, institucionet shkencore që kanë lidhje me këtë, sepse

ne mund të bëjmë çudira, mund të marrim nga Universiteti i Arteve dhe ta kalojmë për faunën për interesa madhore.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po mund të marrin një bexh dhe ta bëjnë edhe ata censusin.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Mund të jetë e saktë rastësisht përfshirja e tyre.

Faleminderit!

Niko Peleshi- Vazhdojmë me pyetjet.

Besnik Baraj – Kam edhe një shqetësim, pavarësisht se në relacion flitet për grupet e interesit që janë përfshirë, unë do të doja të dija Fakulteti i Shkencave të Natyrës, muzeu përkatës, Fredinand Bego, që është një nga specialistët më të mirë të faunës së bashku me kolegët e tij, a janë përfshirë? Unë kam komunikuar dhe i kam thënë që kemi interes ta dëgjojmë, por tani ishte në ekspeditë me studentët.

Ardit Konomi - Duket që projektligji është vendosur në një mjedis që nuk përkon me statuskuonë e sotme të moratoriumit të gjuetisë. Unë do të doja të dija nëse ka një ligj të ri për gjuetinë apo do të jetë moratoriumi ai që do të vijojë, prej të cilit, në fakt, nuk kemi marrë rezultatet e pritshme.

Së fundi, absolutisht duhet bërë censusi për speciet autoktone, por edhe për shtegtarët.

Halil Jakini-Me cilat grupe interesi është konsultuar, me profesorë dhe biologë të njohur të Fakultetit të Shkencave Pyjore? Ku i bihet ndesh moratoriumt të pyjeve? A do të ketë leje, apo në të ardhmen do të zbatohet moratoriumi që askush nuk do të japë leje?

Së fundi, sipas mendimit tim, meqenëse është ndryshuar ligji ekzistues kaq shumë, më mirë të kishim një ligj të ri.

Niko Peleshi - A ka pyetje të tjera? Jo. Atëherë kalojmë te përgjigjet.

Elvana Ramaj– Po ndalem te pyetja e parë, e cila ka të bëjë me faktin e ndryshimit të pjesës më të madhe të neneve të projektligjit. Nuk është pjesa më e madhe e neneve që ndryshon.

Historiku i amendimit të ligjit për faunën e egër daton dy vjet përpara kur për shkak të ndryshimeve të reformës territoriale dhe organeve të shërbimit pyjor, ne vlerësuam që duhet të ndërhyjmë. Në fazën fillestare dhe gjatë të gjithë procesit tonë jemi asistuar nga një projekt i UNDP-së për mbrojtjen e natyrës nëpërmjet të cilit në bashkëpunim të ngushtë me pedagogët dhe kërkuesit e Fakultetit të Shkencave kemi bërë vlerësimin nëse duhet të kishim një ligj të ri, apo amendim të ligjit ekzistues.

Jemi asistuar nga një konsulencë ekspertësh kombëtarë, nga profesor Andri Vaso dhe juristi Erion Muharremaj në bashkëpunim me stafin teknik dhe juridik të ministrisë dhe kemi dalë në përfundimin që kemi të bëjmë me një amendim, pasi nuk preket më shumë se 50 % e dispozitave të projektligjit.

Gjatë procesit jemi konsultuar në vijimësi me ekspertët e mirënjohur që përmendët, përveç profesor Begos, do të përmendja edhe zotin Bino, si ekspert të shpendëve, edhe ekspertë të tjerë për faktin se kemi qenë të suportuar nga një projekt dhe kemi pasur mundësinë financiare si staf të organizojmë disa tryeza të rrumbullakëta...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Bego ka qenë i pranishëm, por jo në të gjitha tryezat për shkak të ngarkesës së tij dhe axhendës shumë të ngjeshur. I është dërguar forma finale e projektligjit.

Kanë qenë 4 konsultime, nga të cilët, ky i fundit është dërguar në Ministrinë e Mjedisit, sipas detyrimit ligjor, ndërsa 3 të tjerët i kemi bërë me ekspertë të fushës.

Është e vërtetë që kemi disa dispozita të direktivave të transpozuar në ligj, por gjuha është ajo që dikton edhe direktivat, për arsye të përafrimit, por numri i këtyre dispozitave të përafruara është i limituar.

Tabela e përputhshmërisë bashkëlidhur tregon se kemi të bëjmë me një numër të kufizuar dispozitash që transpozohen, kjo edhe për faktin se dy direktivat kryesore, ajo e shpendëve dhe ajo e habitateve, në momentin që projektligji filloi të draftohej, kanë qenë të përafruara në masën 90-92 %, pra jemi në një fazë të avancuar.

Me miratimin e këtij projektligji arrijmë në shifrat 95-98 %, gjë e cila është vlerësuar edhe në raportin e fundit të Komisionit European për Shqipërinë. Në këtë raport thuhet shprehimisht: “Përafrimi i direktivave kryesore të natyrës (të dyja direktivave që përmenda) është në një fazë të avancuar”. Sigurisht, na del si detyrë e madhe forcimi i zbatimit, por me përafrimin jemi në terma të avancuar.

Lidhur me pyetjen e profesor Barajt, që ka të bëjë me zonat me interes për komunitetin european, shqetësimi është i drejtë. Dua t’ju informoj se çështjet që ngritët në lidhje me përkufizimin ndaj autoritetit që shpall këto zona, janë trajtuar në ligjin e ri për zonat e mbrojtura të vitit 2017. Kështu që kemi një plotësim të këtij kuadri.

Në këtë projektligj kemi adresuar ato detaje për të cilat nuk jemi shprehur aty, për të realizuar përafrimin e plotë.

Në lidhje me inventarin e llojeve të faunës së egër, në kushtet e moratoriumit të gjuetisë, sigurisht që porosia e komisionit ka qenë në vëmendjen tonë. Dua t’ju informoj që prej vitit 2015 edhe falë suportit të projektit IPA 2013, është viti i katërt që realizojmë

censusin e shpendëve me ekspertë të fushës, ku të gjithë ekspertët e Fakultetit të Shkencave të Natyrës, pa përjashtim, kanë qenë të kontraktuar si konsulentë të projektit. Në vitin 2019, censusi i fundit ka pasur 16 ekspertë të Fakultetit të Shkencave të Natyrës të florës dhe faunës, të Kopshtit Botanik, të Qendrës Kërkimore, pra ka qenë gjithëpërfshirës.

Rezultatet janë...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Bëhet çdo vit. Është censusi që kryhet në periudhën janar-shkurt që fokusohet te llojet migratore dhe vit pas viti duke përfutur edhe nga financimi i projektit IPA, ka ardhur duke u zgjeruar.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Këto bëhen në këtë kuadër, ndërkohë, për pjesën tjetër të llojeve të faunës, përsëri kemi pasur mbështetje nga ky projekt dhe është zbatuar nëpërmjet Agjencisë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura. Vjet është ngritur sistemi që ne e quajmë ndihmës, për të dhënat e llojeve të faunës. Rezultatet e para kanë dalë në periudhën vjeshtë-dimër të vitit 2018 dhe është në proces konsolidimi. Është një sistem *online*, nëpërmjet të cilit 12 agjencitë rajonale të zonave të mbrojtura hedhin *online* të dhënat që marrin pasi janë trajnuar me metodologjinë e caktuar nga një grup i përbashkët ekspertësh italianë dhe shqiptarë.

Faleminderit!

Robert Bitri - Pra, në qoftë se ne sot kërkojmë informacion për censusin e faunës autoktone, jo migratore, a e ka realizuar këtë studim ministria, për të bërë më pas klasifikimin e specieve? Në qoftë se nuk e ka realizuar, sa kohë ju duhet për ta bërë, se ka qenë edhe një nga kriteret?

Ne do të heqim moratoriumin pasi të kemi realizuar censusin, do të shikojmë cilat specie janë në rrezik e të tjerë, dhe mbi bazën e saj do të nxjerrim aktet ligjore përkatëse.

Elvana Ramaj – Të dhënat e konsoliduara të vitit të parë janë të vlefshme, pra janë të disponueshme. Sigurisht që kemi filluar me 19 lloje vitin e parë, këtë vit është shtrirë në 30 lloje dhe vit pas viti do të vijë duke u rritur. Në qoftë se arrijmë në shifrat, sipas vlerësimit të ekspertëve, 50 llojet kryesore të faunës së egër, flasim për gjitarët e mëdhenj, shpendët kanë censusin e vetë dhe gjitarët e ujit apo llojet e tjera, të cilat ne i quajmë llojet kryesore përfaqësuese, atëherë ne jemi në një vlerësim shumë të përafërt dhe të saktë.

Gjithashtu, gjatë kësaj kohe, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, përsëri në bashkëpunim me projektin natyral, Agjencinë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura, ka realizuar ngritjen e platformës së parë kombëtare për biodiversitetin që është quajtur me emrin “BIONA”, është një portal që është bërë aktiv në vjeshtën e vitit 2018, që siguron

marrjen e të dhënave jo vetëm nga 12 ADZM-të, apo nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit, por edhe nga projekte të ndryshme në mënyrë që të mos kemi humbje të të dhënave. Të gjitha vlerësimet dhe studimet që bëhen për llojet është dizajnuar në mënyrë të tillë që të na japin atë që duam, një situatë të qartë dhe një pamje reale për të ngritur dhe përmirësuar politikat tona mbi këtë bazë.

Niko Peleshi - Kishte edhe një pyetje për moratoriumin.

Elvana Ramaj – Në përgjigje të pyetjes së zotit Konomi, moratoriumi aktual përfundon në vitin 2021, ndërkohë që kemi pasur një iniciativë për të amenduar projektligjin për gjuetinë, dhe më vonë në bashkëpunim edhe me ekspertët kombëtarë dhe ndërkombëtarë, u sugjerua që amendimi i këtij ligji, apo një ligj i ri mbetet për të vlerësuar kur të fillojë puna. U shty për një periudhë dyvjeçare deri në vitin 2021 në mënyrë që të mos kemi keqperceptim, që nga njëra anë kemi moratoriumin dhe nga ana tjetër po amendojmë ligjin e gjuetisë.

Kemi një draft të parë, por që është parashikuar për vitin 2021 në PKIE, siç është informacioni, ndërkohë që për moratoriumin e gjuetisë bëhet vlerësimi në përfundim të këtyre raporteve të monitorimit të shpendëve të ujit dhe të llojeve të tjera, rezultatet janë premtuese. Interpretimi i të dhënave nga shkencëtarët është pozitiv. Mbetet për të parë që kur të afrohem në vitin e fundit të moratoriumit, të bëhet vlerësimi në qoftë se do të kemi një propozim për një moratorium të ri.

Në lidhje me pyetjen tuaj për llojet shtegtare, censusi është ky i dimrit që mbulon këto lloje. Siç thashë, është viti i katërt që kryhet. Edhe këtu kemi arritur që vit pas viti të kemi shtimin e numrit të lagunave në të cilat bëhet inventarizimi. Interpretimi dhe përpunimi i të dhënave i fundit të marsit 2019, është pozitiv dhe premtues.

Në lidhje me pyetjen se me cilat grupe interesi është konsultuar, ju bëj me dije që është konsultuar me grupe interesi në bazë të gjerë. Fillimisht, siç e thashë kanë qenë takime teknike me ekspertët e fushës, kryesisht me profesorët dhe pedagogët e Fakultetit të Shkencave Natyrore. Bashkëpunojmë edhe me ekspertët e Universitetit Bujqësor, ku kemi profesorin Spasi Shumka, që kontribuon dhe është aktiv, ndërsa për problemet e pyjeve kemi zotin Tërmani dhe disa ekspertë të tjerë.

Niko Peleshi – Faleminderit!

A ka pyetje të tjera?

A diskutime?

Po, fjalën e ka zoti Gjuzi. Më pas fjalën e ka zoti Jakimi dhe zoti Konomi.

Kujtim Gjuzi – Faleminderit!

Ju thoni këtu për të rivendosur një afat të gjatë kohor. A mund të ma shpjegoni se sa është ky afat? Sepse afat të gjatë ne quajmë periudhën nga 1 deri në 2 vjet.

(Diskutime pa mikrofon)

Faleminderit!

Niko Peleshi – Kjo është një arritje e madhe për ty, zoti Beqaj.

Po, zoti Jakimi.

Halil Jakimi – Për llojet e rrezikuara, siç është rasti i ariut të murrme ose i rrëqebullit në zonën e Librazhdit, kemi një projekt studimi ku janë instaluar kamera për të vëzhguar lëvizjen e tyre apo keni ndonjë mbështetje në këtë drejtim? E para.

E dyta. A ka ndonjë procedim nga ana e inspektorateve të qarqeve në lidhje me gjuetinë e paligjshme? A keni ndonjë informacion sa u takon këtyre procedimeve? Pra, edhe pse moratoriumi është në fuqi, gjuetia e paligjshme ka rënë, por përsëri ka raste ku kjo dukuri ndodh.

Faleminderit!

Niko Peleshi - Zoti Konomi.

Ardit Konomi – Unë kam një koment në vijim të asaj që sapo u tha. Po ta lexosh në brendësi këtë propozim, shpeshherë duket që është i vendosur në realitetin që ju thashë unë dhe jo në atë të moratoriumit, në një realitet ku gjuetia është funksionale dhe ku shoqata e gjuetisë përmendet nominalisht në shumë raste, të cilët janë pjesë e hartimit të planit menaxhues e shumë gjëra të tjera. Unë e njoh shumë mirë këtë pjesë dhe nuk mendoj se moratoriumi ka dhënë rezultatet e pritshme, sepse sot realisht jemi në kushtet ku gjuetia zhvillohet dhe organet tona ligjzbatuese ndoshta nuk kanë mundësi ta monitorojnë gjithë territorin për shkak të madhësisë dhe shtrirjes së tij në zonë, të cilat nuk mund të kontrollohen. A vlen që ne t'i qëndrojmë këtij moratoriumi deri në vitin 2021 apo ndoshta tani është momenti të hedhim një hap tjetër dhe ta rregullojmë gjithë këtë aktivitet?

Niko Peleshi – A ka pyetje të tjera? Nuk ka.

Ju lutem, mund të përgjigjeni!

Elvana Ramaj – Faleminderit!

Në lidhje me monitorimin e llojeve të rrezikuara, sigurisht që ne asistohemi dhe bashkëpunojmë me institucione kërkimore shkencore, por edhe me shoqata të ndryshme. Doja të sillja në vëmendjen tuaj që për rastin e rrëqebullit është shoqata PPNEA, Shoqata për Ruajtjen e Mjedisit Natyror në Shqipëri, e cila nëpërmjet projekteve me financim të huaj në të cilat ajo merr pjesë, ka bërë një punë të lavdërueshme për vendosjen e kamerave kurth, dhe ne kemi rastet e para të evidentuara në zonën e Munellës kryesisht, por edhe më gjerë. Falë

kësaj pune janë përgatitur edhe studime për këtë specie, por kjo është edhe si një detyrim, sepse është një specie e rrezikuar, e cila duhet ndjekur dhe monitoruar nga ministria.

Gjithashtu, janë përgatitur raportet e biodiversitetit dhe studime të ndryshme, si dhe kemi një propozim për shpalljen e zonës së Munellës si zonë e mbrojtur...

(Diskutime pa mikrofon)

Është një popullatë që lëviz midis Shqipërisë dhe Maqedonisë, e cila vlerësohet në shifrat 50 deri në 80 individë. Kjo specie quhet rrëqebulli i Ballkanit. Para disa kohësh, besoj se ju do ta keni ndjekur, ministri Klosi dhe ministria që ai përfaqëson kanë organizuar një event në afërsi të zonës dhe ministria është në fazën e vlerësimit të propozimit, duke marrë edhe iniciativën për ta shpallur Munellën “zonë të mbrojtur”.

Në lidhje me procedimin për gjuetinë e paligjshme, kjo lloj gjuetie është reduktuar shumë, por nuk mund t’ju them se nuk ka gjueti të paligjshme, për këtë gjë jemi të vetëdijshëm. Inspektorati Shtetëror i Mjedisit, i Pyjeve dhe Ujërave, në bashkëpunim me Policinë e Shtetit dhe me Agjencitë Rajonale të Zonave të Mbrojtura në qarqe monitoron situatën. Sigurisht, kemi edhe procedime, për momentin të dhënat nuk i kam këtu me vete, por mund t’ju siguroj raportet periodike që inspektorati bën për...

(Diskutime pa mikrofon)

Moratoriumi i gjuetisë, ndërkohë që Inspektorati Shtetëror çdo 3-mujor dhe në bazë 6-mujore, më pas edhe në kuadër të raportimit të kontributit për progres-raportin e BE-së jep shifra për procedimet që kryhen për gjuetinë e paligjshme. Edhe në këtë proces ne jemi asistuar nga shoqata të ndryshme si PPNEA apo Shoqata Ornitologjike Shqiptare, të cilat në kuadër të projekteve që zbatojnë formulojmë të dhëna, kryejnë vëzhgime në terren dhe formulojnë raporte, të cilat më pas i përcjellin në ministri dhe më pas ato integrohen me të dhënat tona.

Sigurisht që ka vend për përmirësim në këtë aspekt dhe ne do të mundohemi ta realizojmë. Ne kemi vlerësuar shumë gatishmërinë dhe ndihmën e dhënë nga ana e Policisë së Shtetit. Nuk mund të themi që gjuetia e paligjshme është zero këto vite, sepse nuk ka ndonjë autorizim në këtë drejtim, por futja e gjuetarëve të huaj në Shqipëri me anë të procedurave duhet të kryhet nga ana e Ministrisë së Mjedisit në bashkëpunim me Ministrinë e Brendshme, prandaj praktikisht kjo është e pamundur.

Sa i takon pyetjes së zotit Konomi, fakti që ne po amendojmë ligjin për faunën e egër nuk do të thotë që po e lejojmë gjuetinë, por thjesht po shfrytëzojmë kohën meqë moratoriumi i gjuetisë është në fuqi, për të përmirësuar dhe plotësuar kuadrin ligjor. Shoqata e Gjuetarëve është parë si partnere, në kuptimin e kontributit që ajo mund të japë për

ndërgjegjësimin e armatës së gjuetarëve sportivë dhe turistikë, duke u dhënë mundësi bashkëpunimi. Madje, ne shpeshherë kemi pasur, sidomos në rastin e moratoriumit të dytë, nga ana e tyre dhe ky proces është kryer në bashkëpunim me ta, duke qenë pjesë e konsultimeve dhe duke dhënë kontributin e tyre nëpërmjet Këshillit Kombëtar dhe trajnimit të gjuetarëve që duan të pajisjen me leje gjuetie. Sigurisht që ministria do të jetë në krye të të gjitha këtyre hapave që po ndërmerren, sepse ne nuk po u hapim portat në kuptimin e diçkaje abuzive, por thjesht po u japim mundësi të bashkëpunojnë dhe të tregojnë pasionin e tyre për faunën e egër dhe gjuetinë, duke pasur si fokus mbrojtjen e faunës.

(Diskutime pa mikrofon)

Unë e vlerësoj shqetësimin tuaj, por ideja është që ligji për mbrojtjen e faunës konsiston më shumë në dispozita mbrojtëse. Është ligji i gjuetisë ai që do të na japë mundësi të hyjmë në këto detaje, por për sa kohë që këto aktivitete janë të lidhura me njëra-tjetrën kuptohet që ka një ndërveprim ndërmjet tyre. Qëllimi kryesor i ligjit ka të bëjë vetëm me ruajtjen, konservimin dhe sigurimin e statusit të favorshëm të ruajtjes që është një ndër detyrat e direktivave.

Niko Peleshi – A ka pyetje të tjera?

A ka diskutime? Nuk ka.

Kalojmë në votimin në parim. Kush është pro me projektligjin “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 10006, datë 23.10.2008 “Për mbrojtjen e faunës së egër”, të ndryshuar””? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kalojmë në diskutimin nen për nen.

A ka ndonjë pyetje për nenin 1?

A e kanë të gjithë matricën apo jo?

Unë kam një matricë të përgatitur nga shërbimi i komisionit me vërejtjet e Komisionit të Integritetit, i cili e ka shqyrtuar projektligjin.

Për nenin 1, për shënimin në fund të faqes, Komisioni i Integritetit shprehet në lidhje me titullin e projektligjit të riformulohet si vijon: “Ky ligj është përafruar pjesërisht me direktivën e Këshillit të Europës nr. 9243, datë 21.05.1992 “Për ruajtjen e habitateve natyrore të florës dhe faunës së egër”, e ndryshuar”. Numri CELEX 31992 L0043 Fletorja Zyrtare e BE-së, seria L, nr. 206, datë 22.07.1992, faqe 7-50, si dhe me direktivën 2009, nr. 147 KE të Parlamentit European, datë 30.11.2009 “Për konservimin e shpendëve të egër”, e ndryshuar”, numri CELEX 32009 LO 147, Fletorja Zyrtare e BE-së, seria L nr. 20, datë

26.01.2010, faqe 7-25”. Pra, ky është shënimi që ndryshohet në fund të faqes me rekomandimin e KE-së. Kush është dakord...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Është përafuar pjesërisht, vlen për të dyja direktivat. Ky ligj është përafuar pjesërisht: pastaj është direktiva 1 dhe direktiva 2.

Kush është dakord me shënimin në fund të faqes sipas variantit të Komisionit të Integritetit? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka. Miratohet.

Kalojmë te shqyrtimi nen për nen.

Neni 1. Kush është dakord sipas variantit të Këshillit të Ministrave? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 2. Nga Komisioni i Integritetit nuk kemi vërejtje, por shërbimi i komisionit vëren: “Neni 45 i ligjit nuk përmban asnjë nga emërtimet e cituara në këtë nen”. Neni 45 ka lidhje me shqyrtimin dhe ankimimin. “Ndryshuar me ligjin nr.41/2013 “Shqyrtimi, marrja e vendimit përfundimtar dhe ankimimi ndaj tij bëhen në përputhje me ligjin “Për inspektimin””. Si ishte ideja?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Zonja Ramaj, a keni ndonjë shpjegim për këtë çështje, në lidhje me nenin 2? Pse është përjashtuar neni 45?

Elvana Ramaj - Jo, ka qenë një ndërhyrje nga Drejtoria Juridike e ministrisë, por mund të sigurojmë një informacion.

Niko Peleshi – Ne jemi tani në votim. Këshilltarët e komisionit çfarë sugjerojnë?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ndoshta nuk është neni 45, por ndonjë nen tjetër. A mund ta shikoni pak, ndërkohë që ne diskutojmë?

“...në të cilin përcaktohen ndryshe emërtimet Agjencia e Mjedisit dhe Pyjeve, Policia Pyjore...”, nuk e kuptoj. “Kudo në ligj, përjashtuar neni 45 në të cilin përcaktohet ndryshe... zëvendësohen përkatësisht me: Agjencia përgjegjëse e Monitorimit” e të tjera. Në nenin 45 çfarë përcaktohet ndryshe? Ndoshta është referenca e nenit gabim.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Nenin 2 po e lëmë pa votuar. Ndërkohë, mund të na jepni një sqarim, se ndoshta është referenca e gabuar. Në fund, i rikthehem dhe nëse kemi një shpjegim, do të votojmë dhe ta mbyllim.

Neni 3 ka dy pika. Nuk kemi vërejtje apo sugjerim nga Komisioni i Integritetit, por kemi disa vërejtje nga shërbimi i komisionit.

Pika 1 e nenit 3. Kush është dakord sipas variantit të Këshillit të Ministrave? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Pika 2. Në këtë pikë kemi: “Ruajtja dhe vendosja në gjendje të favorshme e habitateve natyrore dhe llojeve të faunës së egër me interes për Komunitetin Europian”. Shërbimi i komisionit, këshilltarët ngrenë pyetjet: cilat janë këto? Si miratohen? Mungon përkufizimi dhe autoriteti që i miraton. Keni ndonjë shpjegim?

Elvana Ramaj - Po, pyetja është shumë e ngjashme me atë që bëri zoti Baraj, se janë çështje që trajtohen nga ligji “Për zonat e mbrojtura”, një ligj i vitit 2017, i cili ka një kapitull të veçantë për këto zona. Zonat me interes për komunitetin, janë ato zona që strehojnë habitate dhe lloje që janë të listuara në anekset e direktivave. Direktiva e habitateve ka dispozitat e saj dhe anekset. Anekset e direktivës konsistojnë në llojet e habitateve me rëndësi për Komunitetin Europian, të cilat duhet të mbrohen dhe për të cilat duhet të sigurohet statusi i favorshëm i ruajtjes. Për të arritur këtë shtetet anëtare, por edhe ne në procesin e avancimit me integrimin duhet të sigurojmë identifikimin dhe shpalljen e këtyre zonave që strehojnë habitate dhe lloje me rëndësi për komunitetin.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ligji “Për zonat e mbrojtura” jep te përkufizimet për zonat me interes për Komunitetin Europian dhe zonat e veçanta të ruajtjes të cilat janë zonat që strehojnë lloje dhe habitate.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Zona shpallet për arsye të habitateve me vlerë që ajo mban. Në këtë rast habitate nuk janë lloje të faunës, janë tërësia e vegjetacionit. Habitatet janë si shtëpia e llojit në terma më të thjeshtë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Habitatet që janë të pranishme në Shqipëri apo ato si habitate janë përcaktuar...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Lista është e miratuar në anekset e direktivës dhe me anëtarësimin e çdo shteti të ri, u jepet mundësia që para miratimit në negociata me Komisionin Europian të shtohen lloje që kanë rëndësi për vendin. Në momentin, për shembull kur është anëtarësuar Kroacia anekset e direktivës kanë pësuar amendimin e fundit. Është një proces negociatash dhe konsultimi dypalësh.

Niko Peleshi - Pra, është e qartë, është sqaruar te ligji tjetër.

Ka pyetje të tjera? Po, zoti Beqaj.

Ilir Beqaj - E ndesh këtu, por edhe më tej: çfarë kuptojmë me Komunitet European?

Elvana Ramaj - Bashkimin European. Disa vite më parë përdornim një term të tillë. Më pas në konsultim me juristët dhe Ministrinë për Europën dhe Punët e Jashtme na është sugjeruar që të përdorim këtë terminologji. Përkufizimet janë shumë afër përkufizimeve të direktivave, pasi nuk mund të lëvizim dot. Në momentin që shtetet, të cilat synojnë të përafrojnë kanë devijime nga përkufizimet e direktivës, atëherë në procesin e *screaming* vlerësohet se nuk është përafruar plotësisht.

Niko Peleshi - A është e qartë? Ka ndonjë pyetje tjetër?

Me vërejtjen për t'u shqyrtuar edhe një herë, për t'u saktësuar edhe një herë gjatë redaktimit të nenit, në lidhje me "Komuniteti European".

E hedhim në votë pikën 2 të nenit 3.

Kush është dakord? Kundër? S'ka kundër. Abstenim? S'ka.

Miratohet!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po, ka një abstenim. Po, zoti Gjuzi. Keni nevojë ta shpjegoni abstenimin, apo jo?

E hedhim në votë në tërësi nenin 3. Kush është dakord në tërësi me nenin 3, sipas variantit të Këshillit të Ministrave? Kundër? Abstenim? Një abstenim.

Miratohet!

Kalojmë në shqyrtimin e nenit 4.

Në lidhje me nenin 4 kemi një vërejtje nga Komisioni i Integritetit, i cili sugjeron disa ndryshime. Në pikën 2 të nenit 4, pika 2/1 të riformulohet si vijon: "Zonë është një hapësirë e përcaktuar gjeografike..."

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jo, jo, po lexoj vetëm vërejtjet e komisionit. Pastaj diskutojmë.

Pra, pikën 2/1 e riformulon si vijon: "Zonë është një hapësirë e përcaktuar gjeografike, shtrirja e së cilës përshkruhet me hollësi". Pra, jo: "Zonë është një zonë e përcaktuar gjeografike", por "Zonë është një hapësirë e përcaktuar gjeografike". Ky është ndryshimi.

Te pika 2/2 riformulohet: "Statusi i ruajtjes së një lloji". Pra, jo "Statusi i gjendjes së një lloji", por "Statusi i ruajtjes së një lloji", e më poshtë vazhdon. Kur themi habitat apo

peizazhi, shtohet: “habitati natyror”. Më poshtë, ku e kemi përsëri “habitati” apo “peizazhi”, duhet “habitati natyror”. Pra, shtohet fjala “natyror”.

Në lidhje me pikën 5, komisioni është “Komisioni i Bashkimit European”; e ndryshojmë dhe e bëjmë: “Komisioni European”. Pra, jo “Komisioni i Bashkimit European”, por “Komisioni European”.

Këto sugjeron Komisioni i Integritetit.

Tani, meqenëse ka disa pika, e hedhim në votë në parim nenin 4. Më pas miratojmë pikat një për një.

Kush është dakord në parim me nenin 4? Kundër? S’ka. Abstenim? 1 abstenim.

Miratohet!

Kalojmë në diskutimin pikë pas pike, të nenit 4.

Pika 1.

Po.

Ilir Beqaj – Te pika 1, në fund të fjalisë apo të paragrafit, ju thoni: “dhe popullatave të llojeve të florës dhe faunës”. Ky ligj është vetëm për faunën. Pse e fusim edhe florën? Sepse është që në titull.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Elvana Ramaj– Faleminderit!

Është përkufizim, prandaj nuk mund t’i ndajmë, gjithashtu, edhe për faktin se në kontekstin e çdo lloji, fauna e egër jeton dhe zhvillohet në një habitat, në një ekosistem të caktuar, që ka përbërjen llojore të florës. Kështu, është një tërësi faktorësh, që...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

E di. Ne kemi pasur një debat...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Që t’i jepet mundësi zhvillimit.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ilir Beqaj – Është ligji i faunës. Habitat, a e ka edhe florën? E ka.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po, por ky është ligj për faunën, s’është ligj për florën.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Le që e zgjidhim me votë, xhanëm.

Niko Peleshi – Dakord!

Në lidhje me pikën 1, ka ndonjë pyetje, vërejtje apo diskutim? Jo.

E hedhim në votë pikën 1 të nenit 4.

Kush është dakord, sipas variantit të Këshillit të Ministrave?

Nuk kemi propozim alternativ.

Kundër? 1. Abstenim? S'ka.

Miratohet, sipas variantit të Këshillit të Ministrave!

Pika 2. Hedhim në votë pikën 2, me ndryshimet e propozuara nga Komisioni i Integritetit.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Urdhëroni!

Ilir Beqaj – Do të sugjeroja që këtu, derisa po përdoret gjithmonë e më tepër, të shtonim edhe pjesën e koordinatave apo referencave gjeohapsinore. Sot çdo zonë është mjedis.

Niko Peleshi – Është përshkrim me hollësi.

Ilir Beqaj – Përshkrim me hollësi, por t'i vëmë standardin, sepse përshkrimi me hollësi mund të jetë edhe narrativ. Kjo mund ta nënkuptohet, po për sa kohë që kemi ligj për gjeoreferencën, përcaktimi më i saktë i çdo zone bëhet në këtë mënyrë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Por të paktën në plan. Sepse nesër, kjo zonë do të regjistrohet në kadastër si zonë e mbrojtur.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Niko Peleshi – Mos harroni se ka edhe akte nënligjore, të cilat bëjnë specifikime.

Ilir Beqaj – Po atëherë ta themi. Akti ligjor nuk del, po nuk u dha këtu e drejta, që kjo të dalë me akte nënligjore.

Niko Peleshi – Hapësira e secilës përshkruhet me hollësi. Se cilat janë hollësitë, sqarohet me akte nënligjore.

Ilir Beqaj – “Sipas akteve nënligjore”, atëherë. Kur ai akti nënligjor të dalë, do të thotë: në bazë të nenit kaq, pika kaq, po nxjerrim këtë akt.

Niko Peleshi – Komisioni i Shërbimit, kështu është? A duhet të kemi patjetër referencë?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Duhet t'i citojmë? Dakord!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Një gjë më bëri përshtypje: që hera e parë që ti tërhiqesh, ishte kjo, me zotin Beqaj. S'ka bërë vaki.

(Ndërprerje e shkurtër incizimi)

Atëherë le ta shtojmë: “Përshkruhet me hollësi në aktet nënligjore respektive”.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Kush është dakord me nenin 2, me vërejtjet e Komisionit të Integritetit dhe shtesën e akteve nënligjore, pas fjalëve: “përshkruhet me hollësi”, në pikën 2/1? Kundër? Abstenim? S’ka.

Miratohet me ndryshimet sipas Komisionit të Integritetit dhe sipas propozimit të zotit Beqaj.

Pika 3. Kush është dakord, sipas variantit të Këshillit të Ministrave? Kundër? Abstenim? S’ka.

Miratohet!

Pika 4. Kush është dakord, sipas variantit të Këshillit të Ministrave? Kundër? Abstenim? S’ka.

Miratohet!

Pika 5. Kush është dakord riformulimin sipas vërejtjeve të Komisionit të Integritetit? Pra: komisioni është Komisioni European, jo Komisioni i Bashkimit European.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po, me sa duket.

Elvana Ramaj – Po, kemi pasur sugjerim nga Ministria për Europën dhe Punët e Jashtme.

Niko Peleshi – Në rregull! Dakord!

Kush është dakord? Kundër? S’ka.

Miratohet me formulimin e bërë sipas vërejtjeve të Komisionit të Integritetit.

Kalojmë te neni 5. Për nenin 5 nuk kemi rekomandime e vërejtje nga Komisioni i Integritetit e as nga Shërbimet e Komisionit.

Kush është dakord me variantin e formuluar nga Këshilli i Ministrave?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

E lamë që do të redaktohet, dhe vlen për të gjitha nenet. Komuniteti European do të jetë me të mëdha, me të vogla, do të jetë “komuniteti” apo një përcaktim tjetër? Këto ia lëmë redaktimit, gjë që vlen për të gjitha nenet.

Kush është dakord me variantin sipas Këshillit të Ministrave? Kundër? Abstenim? S’ka.

Miratohet neni 5!

Kalojmë te neni 6.

As për nenin 6 nuk kemi vërejtje.

Kush është dakord me variantin e Këshillit të Ministrave? Kundër? Abstenim? S'ka.
Miratohet!

Kalojmë te neni 7, në pikën 1 të nenit 7 thuhet: “pas shpallje së një zone si zonë me interes për komunitetin europian”. Edhe këtu kemi vërejtje nga shërbimet e komisionit, të cilët duan të dinë se me çfarë akti bëhet shpallja e zonës dhe cili është autori që e shpall?

Elvana Ramaj – Aktualisht ka një vendim të Këshillit të Ministrave, i cili përsëri ka dalë në zbatim të ligjit për zonat e mbrojtura. Ky është një vendim i hartuar dhe miratuar në fund të vitit 2018 për shpalljen e zonave të veçanta të ruajtjes. Mund t’ju siguroj numrin dhe datën për referencën.

Niko Peleshi – Dakord.

Atëherë hedhim në votim nenin 7. Kush është dakord?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Elvana Ramaj – Është pushteti vendor, institucionet kërkimore shkencore, qoftë edhe shoqata, të cilat në studimet e tyre shkencore vërtetojnë që janë zona të ashtuquajtura “Natyra 2000”, të cilat janë një ndër detyrimet kryesore të fushës së mbrojtjes së natyrës. Vendimi i Këshillit të Ministrave, i miratuar pak kohë më parë, detajon që ky proces i nënshtrohet një procedure konsultimi të zgjeruar për vetë rëndësinë që ka.

Faleminderit!

Niko Peleshi – Ndërkohë për pikën 2 të nenit, ku thuhet: “Autoritetet kompetente miratojnë planin”, shërbimi i komisionit rekomandon se kjo duhet të përcaktohet me ligj se cilat janë këto autoritete kompetente.

Elvana Ramaj – Ideja jona ka qenë që në këto raste, për zonat me rëndësi për komunitetin europian, pra zona “Natyra 2000”, sigurisht që duhet lënë një hapësirë për projekte, të cilat janë me rëndësi kombëtare...

Niko Peleshi – Cilat janë autoritetet kompetente?

Elvana Ramaj – Në vlerësimin tonë, autoriteti kompetent ka qenë Këshilli Kombëtar i Rregullimit të Territorit.

Niko Peleshi - Ku është përcaktuar kjo?

Elvana Ramaj -Në vendimin e Këshillit të Ministrave kemi specifikuar që duhet të kemi dispozita të tilla, të quajtura “përgjashtimore”, pra vetëm në raste kur kemi të bëjmë me projekte madhore me rëndësi për vendin...

Niko Peleshi –Ku përcaktohet që autoriteti kompetent është Këshilli Kombëtar i Territorit, siç e thatë ju, që miraton planin apo projektin?

Elvana Ramaj – Ka një referencë me ligjin për zonat e mbrojtura dhe ka një nen në ligj, i cili përcakton se çdo zonë e mbrojtur dhe zonat “Natyra 2000”, si një lloj i veçantë, zonimi i brendshëm i tyre miratohet me vendim të këtij organi. Kjo ka ardhur për të adresuar problematikën që kemi ndeshur ndër vite kur...

Niko Peleshi- Dakord. A mund ta shtojmë si referencë këtu: “Autoritetet kompetente miratojnë planin”?

Elvana Ramaj – Dakord.

Niko Peleshi – Në nenin 3 thuhet: “Miratohen masa kompensuese”

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Konsultimi, dëgjesa. Mund ta heqim fjalën “të gjerë” dhe lëmë “të publikut”.

T’i bësh një ftesë të hapur publikut, le të vijë kush të dojë. Këtë quaj unë dëgjese publike të hapur.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Në qoftë se do të bësh një projekt në një zonë të caktuar, do të ftosh të gjithë komunitetin.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Nuk është grup interesi komuniteti, por është publiku i gjerë. Popullsia e Tiranës është grup interesi? Nëse bën diçka te parku i liqenit, do të ftosh në një dëgjese publike të gjithë popullsinë e Tiranës. Prandaj, për mendimin tim, nuk duhen bërë grupe interesi, sepse lë vend për abuzim, mund të thërrasësh dy shoqata dhe je në rregull me ligjin.

Kalojmë te vërejtjet e pikës 3, ku në fjalinë e parë thuhet: “Miratohen masa kompensuese”. Pyetjet nga shërbimi janë: çfarë natyre kanë këto masa kompensuese? Natyra dhe llojet e masave duhet të përcaktohen me ligj.

Elvana Ramaj– Aktualisht, në ligjin ekzistues për mbrojtjen e faunës së egër ka një nen që adreson masat kompensuese dhe për këtë arsye nuk është gjykuar e nevojshme që të zgjatemi.

Niko Peleshi – Xhilda, a duhet vendosur referenca?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Elvana Ramaj – Në këtë ligj ka qenë ideja për këtë nen.

Niko Peleshi – Ku përcaktohen masat kompensuese?

Elvana Ramaj – Te ligji ekzistues.

Niko Peleshi – Atëherë, a duhet vendosur referenca sipas përcaktimeve në këtë ligj?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Dakord.

Vërejtja tjetër lidhet me përcaktimin: “Komisioni informohet për masat kompensuese të miratuara”. Kur hyn në fuqi ky detyrim, sepse vendosja e tij në ligj nuk ka kuptim? Transpozimi i direktivës duhet të përshtatet me gjendjen aktuale.

Elvana Ramaj– Kjo dispozitë do të hyjë në fuqi në momentin kur Shqipëria të bëhet anëtare me të drejta të plota, por, ndërkohë, në procesin e përgatitjes shtetet candidate inkurajohen që të avancojnë me transpozimin dhe me zbatimin e direktivës.

Niko Peleshi –Dakord, por ne nuk mund të transpozojmë diçka që nuk ka sens.

Elvana Ramaj – Do të ekzistojë në një të ardhme...

Niko Peleshi – Kur në një të ardhme?

Elvana Ramaj – Kuptohet që bëhet fjalë për Komisionin European.

Niko Peleshi – A ka sens që ne të informojmë komisionin në fund të vitit për masat kompensuese të miratuara?

Elvana Ramaj – Jo, ndoshta mund të vendosim një afat kohor nëse e shikoni të arsyeshme.

Niko Peleshi – Xhilda, çfarë propozoni ju?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Elvana Ramaj – Është dispozitë e direktivës dhe është shprehimisht e formuluar në këtë formë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po, por në atë moment duhet shprehur edhe në ligj, sepse shërbimet e Komisionit European nuk e quajnë të transpozuar në qoftë se nuk është në këtë formë.

Niko Peleshi – Dakord, ligji është 95% i përafëruar aty, por nuk është i transpozuar. Propozimi ynë është të heqim këtë fjali dhe, kur të anëtarësohemi në Bashkimin European, ku 95%-in do ta bëni 100%, do të shtohet edhe kjo fjali.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Elvana Ramaj – A është e mundur që fjalia të mbetet dhe të shtohet një afat kohor, sepse edhe shkalla e transpozimit...

Niko Peleshi –T’i vendosim një afat kohor Bashkimit European kur të na anëtarësojë?

Elvana Ramaj – Komisioni informohet për masat kompensuese të miratuara duke filluar nga momenti i anëtarësimit. Ne monitorohemi çdo vit në progresin e avancimit me përafrimin...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Është progres

Niko Peleshi - Ne nuk mund të bëjmë një ligj dhe të shprehemi se ky nen vlen kur Shqipëria të bëhet anëtare e Bashkimit European.

Elvana Ramaj – Dakord, mund ta lëmë për një moment të dytë.

Niko Peleshi - Ndryshe i bie t'i transpozojmë mot a mot të gjitha ligjet dhe në fund fare i fusim një shënim në fund, që këto vlejné pas anëtarësimit në Bashkimin European. Nuk po kalojmë dot në transpozim 100% të të gjitha ligjeve, por po bëjmë përafrim të legjislacionit për këto shkaqe. Atëherë, këtë fjali po e heqim dhe, kur të ndryshohet ligji, e shtojmë edhe këtë fjali.

Atëherë, e hedhim në votë pikën 1 të nenit 7.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Në parim e kemi miratuar nenin 7, tani kalojmë pikë pas pike.

Urdhëroni!

(Mungesë regjistrimi)

(Diskutime pa mikrofon)

Mund të na përgjigjet zonja Ramaj, mbase kjo është terminologjia e ligjit. Nuk quhen “programe menaxhimi”, por quhen “planet e menaxhimit dhe projektet”, pra nuk kemi programe në këtë terminologji të ligji.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Dakord, por në rastin e florës, faunës, pyjeve e të tjera quhen plane të qëndrueshme menaxhimi.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Këtu nuk bëhet fjalë për programet e qeverisë, bëhet fjalë për programet në kuptimin e ligjit. Pra, për planet e menaxhimit të zonave, të habitateve... *(Ndërhyrje pa mikrofon)*

(Zoti Gjuzi flet pa mikrofon)

Unë kuptoj që këtu kemi plane menaxhimi dhe projektet në zbatim të planeve.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Atëherë, kemi një propozim alternativ kur të vijë radha, do ta hedhim në votë. E kemi miratuar në parim, e miratojmë pikë pas pike. Kush është dakord me pikën 1? Kjo pikë nuk ka ndryshuar, sepse vërejtjen, që bëri shërbimi i komisionit, e shpjegoi zonja Ramaj.

Kush është dakord me variantin e Këshillit të Ministrave për pikën 1 të nenit 7? Kundër? Abstenim? 1 abstenim.

Miratohet.

Kalojmë te pika 2.

E hedhim në votë pikën 2 me këto ndryshime. Po e nis nga fundi, heqim mbiemrin “të gjerë” dhe lëmë vetëm mendimin e publikut në fjalinë e fundit të pikës 2, ndërkohë shtojmë referencën tet autoritetet kompetente “sipas përcaktimit të ligjit për zonat e mbrojtura”. Ndryshimi i zotit Gjuzi, i cili, pak a shumë, mund të formulohet kështu: “Autoritet kompetente miratojnë planin ose projektin në kuadrin e programit përkatës të qeverisë vetëm pasi të konstatohet e të tjera”. Ndërkohë që varianti tjetër është pa programin e qeverisë.

E hedhim në votë nenin me ndryshimet që përmenda më lart dhe me propozimin e zotit Gjuzi.

Kush është dakord? 7 pro. Kundër? 2 kundër. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet me ndryshimet që propozon zoti Gjuzi dhe me ato që përmenda.

Po e lexoj të plotë dhe ju duhet vetëm ta redaktoni.

“Çdo plan ose projekt që nuk lidhet drejtpërdrejt, por mund të ketë një ndikim të rëndësishëm në zonën me interes për Komunitetin European i nënshtrohet procesit të vlerësimit të ndikimit në mjedis. Autoritetet kompetente, sipas përcaktimeve të ligjit për zonat e mbrojtura, miratojnë planin ose projektin në kuadrin e programit qeverisës, vetëm pasi të konstatohet në raportin e vlerësimit të ndikimit për zonën dhe llojet se ai nuk do të ndikojë negativisht në integritetin e zonës në fjalë dhe vetëm pas marrjes së mendimit të publikut”.

Kjo u miratua.

Ilir Pendavinji – Janë propozime të ndryshme, të cilat duhet të hidhen në votim të ndara. Nuk mund të bashkosh dy propozime që nuk kanë lidhje me njëri-tjetrin.

Niko Peleshi – U miratua dhe nuk besoj se na...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Mbaje shënim dhe, po deshët, bëjeni amendim në seancë.

Neni 7 pika 3.

Kush është dakord me pikën 3 të nenit 7? “Miratohen masa kompesuese”, duhet të shtojmë referencën “sipas përcaktimeve në këtë ligj”.

Fjali e fundit: “Këto masa përcaktohen me urdhër të ministrit, me qëllim sigurimin e koherencës së përgjithshme të rrjetit të zonave me interes...”, pra heqim fjalinë e fundit. “Komisioni informohet për masat kompesuese të miratuara”, hiqet fjalia e fundit dhe vendoset “referenca”.

Kush është dakord me pikën 3 të nenit 7, me ndryshimet e bëra? Kundër? Abstenim?

Miratohet pika 3 e nenit 7.

Kalojmë në votimin në tërësi të nenit 7.

Kush është dakord në tërësi me nenin 7? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 8.

Te neni 8 kemi një vërejtje lidhur me përcaktimin “qeverisje qendrore”, e cila sugjerohet të zëvendësohet “me ministrit e linjës apo agjencitë zbatuese” nga shërbimi i komisionit. A keni ndonjë mendim, zonja Ramaj?

Ju thoni: “Ministria në bashkëpunim me qeverisjen qendrore”. Mos ndoshta duhet thënë: “Ministria në bashkëpunim me ministritë e linjës apo me agjencitë zbatuese”. Si mendoni?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Elvana Ramaj – Mund të modifikohet. Ne këtë nen e kemi konsultuar edhe me këshillin konsultativ të vetëqeverisjes vendore. Ajo që përmendët ju: “ministritë e linjës dhe institucionet e varësisë”, por neni bëhet shumë i gjatë...

Niko Peleshi - Propozimi është ky: “Ministria në bashkëpunim me ministritë e linjës dhe agjencitë ligjzbatuese dhe njësitë e qeverisjes vendore...”

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po ka edhe ministri të tjera linje.

Po mund të ketë disa. Për shembull, mund të jetë Ministria e Bujqësisë, ose në një moment të caktuar mund ta kemi të ndarë turizmin nga mjedisi.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Çfarë keni parasysh me qeverisje qendrore?

Elvana Ramaj – Ideja jonë ka qenë që të listojmë të gjithë institucionet, që përfshihen në këtë proces për vetë faktin se kemi të bëjmë me plane veprimi për lloje të kërcënuara dhe endemike, që janë shumë të rëndësishme për biodiversitetin. Nga eksperiencia, kemi pasur raste kur ka pasur planin e veprimi, që miratohen me urdhër të ministrit përgjegjës për mjedisin, ndërkohë që një ministri tjetër nuk ka qenë shumë e interesuar ndonjëherë...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Niko Peleshi – E hedhim në votë nenin 8 me ndryshimin si më poshtë: “Ministria në bashkëpunim me ministritë e tjera të linjës dhe agjencitë zbatuese, njësitë e vetëqeverisjes vendore, institute të specializuara, organizata jofitimprurëse dhe me persona fizikë dhe juridikë...”

Xhilda, çfarë mendimi keni për këtë, të hiqet?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Niko Peleshi – Çfarë nënkuptoni me “persona fizikë dhe juridikë”?

Elvana Ramaj – Ky përcaktim është vënë me idenë që të kemi një kontribut me bazë të gjerë. Ka raste kur shoqatat janë një kategori, ato të specializuara, që mund të na sigurojnë kontribute të tilla, por ka edhe persona fizikë dhe juridikë që janë në gjendje të na ...

Niko Peleshi – Ekspertët për shembull. Apo një kompani e caktuar.

Elvana Ramaj – Pikërisht. Ideja ka qenë të mos e ngushtojmë mundësinë e kontribimit. Sigurisht, të specializuara dhe që kanë atributet e duhura, sepse nuk bëhet fjalë për ...

Niko Peleshi - Xhilda, si mendon?

(Diskutime pa mikrofon)

Çfarë mendimi keni për vërejtjen “persona fizikë dhe juridikë”? Duhet të jetë apo nuk duhet të jetë?

(Diskutime pa mikrofon)

Ju lutem, me mikrofon, zoti Pendavinji!

(Diskutime pa mikrofon)

Duhet të jetë.

Ka ndonjë propozim për ta hequr?

(Diskutime pa mikrofon)

Të lëmë. Dakord.

Atëherë, vazhdojmë me formulimin: “Organizata jofitimprurëse, dhe me persona fizikë dhe juridikë, harton planet e veprimit për ruajtjen e llojeve të kërcënuara dhe endemike. Planet miratohen me urdhër të ministrit”.

Kush është dakord me këtë formulim? Kundër? Nuk ka.

Miratohet neni 8.

Neni 9.

Për nenin 9 kemi disa vërejtje.

Xhilda, çfarë keni pasur parasysh për këtë që keni nënvizuar, keni halajtur, te neni 8?

(Diskutime pa mikrofon)

Jo, pas pikës 3 të nenit 8. E keni halajtur nenin 8.

(Diskutime pa mikrofon)

Dakord.

Më poshtë vazhdojmë: “Në zona të caktuara mjedisore në pyje dhe kullota në administrim të njësisë së qeverisjes vendore”. Cilat mund të jenë këto zona? Kush dhe si i përcakton? Sipas përcaktimeve të Kodit Civil, subjekti që ka në pronësi ose posedim pronën

gëzon edhe të drejtën e administrimit që përfshin edhe të drejtën për ta menaxhuar lirisht atë. Në këtë rast, njësitë e qeverisjes vendore që kanë në administrim pronën bëjnë edhe menaxhimin e saj.

Duhet pasur në konsideratë parimi kushtetues i ndarjes së pushteteve dhe respektimi i të drejtës së pronësisë së njësisë së qeverisjes vendore, që përfshin edhe administrimin apo menaxhimin e saj. Ky është argumentimi i vërejtjes. Si mendoni ju? “Në zona të caktuara mjedisore në administrim të njësisë së qeverisjes vendore”. Pra, cilat janë zonat e caktuara mjedisore? Për ekosistemet, habitatet, si edhe për llojet e faunës së egër me status të mbrojtjeje, që ndodhen jashtë rrjetit përfaqësues të zonave të mbrojtura, në zona të caktuara mjedisore dhe në pyje dhe kullota në administrim të njësisë së qeverisjes vendore, hartohen plane menaxhimi që miratohen me urdhër të ministrit. Cilat janë zonat e caktuara mjedisore?

Elvana Ramaj– Ideja ka qenë që kemi të bëjmë me lloje të faunës së egër, që gëzojnë një status mbrojtjeje, të kërcënuar apo shumë të kërcënuar. Bëhet fjalë për zona që janë jashtë rrjetit përfaqësues të zonave të mbrojtura. Detyrimi i ministrisë në këtë rast është që të sigurojë dispozita për mbrojtjen e tyre....

Niko Peleshi – Më fal, që të mos zgjatem!

Për gjithë të tjerat jemi dakord dhe i kuptojmë, por duam informacion për përcaktimin e papërcaktuar. Cilat janë zonat e caktuara mjedisore? Një zonë e caktuar mjedisore është edhe lulishtja e Kuvendit.

Elvana Ramaj - Ideja është që kemi një lloj të faunës së egër të mbrojtur, për të cilën duhet të sigurojmë mbrojtjen e habitatit të tij ku ky zhvillohet, që është një zonë e caktuar mjedisore dhe jashtë rrjetit përfaqësues të zonave të mbrojtura.

Niko Peleshi – Kush i përcakton këto zona?

Elvana Ramaj – I përcakton harta e shpërndarjes së këtij lloji.

Niko Peleshi – Nuk ka referencë fare. Thuhet “në zona të caktuara mjedisore”.

Zonë e caktuar mjedisore është çdo zonë.

(Diskutime pa mikrofon)

Atëherë do ta heqim shprehjen “zona të caktuara”.

(Diskutime pa mikrofon)

Elvana Ramaj- ... i përhapjes së llojit.

Niko Peleshi – Me radhë ju lutem!

Urdhëroni!

Besnik Baraj – Bëhet fjalë për një specie që nuk ndodhet vetëm në zonat e mbrojtura, por është specie e rrezikuar.

Atëherë, në ato zona ku ky jeton, jashtë zonave të mbrojtura, adresohet kjo.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Në ato zona ku kjo specie jeton.

Niko Peleshi – Kush i cakton këto zona, se kjo e zgjidh? E zëmë se kemi një realitet të tillë.

Besnik Baraj – Specia atje ku jeton.

Niko Peleshi – Besnik, në oborrin e Kuvendit ...

(Diskutime pa mikrofon)

Dakord. Kush e cakton? Kush ia jep statusin “zonë e caktuar mjedisore”?

(Diskutime pa mikrofon)

Me urdhër ministri? Agjencia e zonave të Mbrojtura?

(Diskutime pa mikrofon)

Besnik Baraj – Këtu thuhet “zona të caktuara që janë jashtë zonave të mbrojtura” dhe “pyje dhe kullota që administrohen nga pushteti vendor”. Shqetësimi im nuk është këtu, por këto që administron pushteti vendor a mund të komandohen nga ministri? Këtu thuhet që për këto që i ka në menaxhim pushteti vendor nxjerr urdhër ministri.

Ilirian Pendavinji - Mund të mos përdoret termi “të caktuara”, por termi “zona të tjera mjedisore”.

(Diskutime pa mikrofon)

Po pra.

Niko Peleshi – Është e përgjithshme.

Elvana Ramaj – Ministri vetëm miraton planin ...

(Diskutime pa mikrofon)

Niko Peleshi –Jo, unë nuk shikoj ndonjë problem tek të tjerat. E vetmja gjë këtu është termi “zona të caktuara mjedisore”, i cili duket si i papërcaktuar dhe i pasqaruar. Nëse kjo është pjesë e terminologjisë së ligjit ose ndonjë ligji tjetër, dakord, por nëse është një gjë evazive, do të ketë vështirësi në zbatim. Cilat janë zonat e caktuara mjedisore. Kush i cakton? Ku caktohen? Ka ndonjë hartë?

Elvana Ramaj - Është harta e përhapjes së llojeve, atë që tha zoti Baraj, që çdo lloj ka arealin e vetë të përhapjes. Në bazë të hartave të gjithëpërpahjes, kur një lloj shpallet i mbrojtur, automatikisht jemi të detyruar ...

Niko Peleshi - Atëherë mund të themi “zona të caktuara mjedisore, sipas hartës së përhapjes së llojit”?

(Diskutime pa mikrofon)

Elvana Ramaj - Dakord, duke nënkuptuar që është areali i përhapjes së llojit.

(Diskutime pa mikrofon)

Niko Peleshi - Propozoj që kjo pikë të riformulohet: “Për ekosistemet, habitatet, si dhe për llojet e Faunës së egër me status mbrojtjeje, që ndodhen jashtë rrjetit përfaqësues të zonave të mbrojtura, në zona të caktuara mjedisore, sipas hartës së përhapjes së llojit, dhe në pyjet e kullotat në administrimin e njësishë së qeverisjes vendore, hartohen plane menaxhimi, që miratohen me urdhër të ministrit”.

Kush është dakord në parim me nenin 9? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kalojmë pikë pas pike.

Pika 4.

Kush është dakord me ndryshimin, sipas propozimit tim? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Pika 5.

Kush është dakord me pikën 5? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Votojmë nenin 9 në tërësi.

Kush është dakord? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 10.

Në nenin 10 kemi një vërejtje për titullin: “Mbrojtja nga lëndët, mjetet e rrezikshme dhe shërbimet”. Cilat janë shërbimet, sepse duket i paplotë? Ndoshta keni harruar diçka.

Elvana Ramaj – Kjo ka të bëjë me vendosjen e kësaj dispozite në zbatim të detyrimeve që rrjedhin nga anëtarësimi në një konventë ndërkombëtare.

Niko Peleshi – Cilat janë shërbimet?

Elvana Ramaj – Shërbimet veterinarë, që përmenden më poshtë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Shërbimi i mbrojtjes së bimëve dhe shërbimi veterinar.

Niko Peleshi – Si ta plotësojmë titullin?

“Shërbimet përkatëse”?

Elvana Ramaj – Jo, lidhet me parandalimin e helmimit të shpendëve shtegtarë.

Niko Peleshi – Me sa duket, ka disa lloje shërbimesh: shërbimi i mbrojtjes së bimëve, shërbimi veterinar.

Besnik Baraj – “Shërbime të ndryshme”.

Më pas i shpjegon teksti.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Niko Peleshi – Ndoshta duhet ta lëmë siç është: “Mbrojtja nga lëndët, mbetjet e rrezikshme dhe shërbimet”. Shërbimet të sqarohen më poshtë me pika.

Elvana Ramaj – “Lëndët dhe mbetjet e rrezikshme”.

Niko Peleshi – Është e qartë. Kush është dakord me nenin 10? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet neni 10, sipas formulimit të variantit të Këshillit të Ministrave.

Neni 11.

Kush është dakord me nenin 11, sipas variantit të Këshillit të Ministrave? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 12.

Nuk ka vërejtje.

Kush është dakord, sipas variantit të Këshillit të Ministrave? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 13.

Nuk ka vërejtje.

Kush është dakord, sipas variantit të Këshillit të Ministrave? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 14.

Nuk ka vërejtje.

Kush është dakord, sipas variantit të Këshillit të Ministrave? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 15.

Kemi një vërejtje.

Te gjysma e fjalisë së fundit: “...kuadri nënligjor, që lidhet me miratimin e listave të tipave të habitateve natyrore, bimëve, kafshëve, shpendëve me interes për Komitetit European”, kush e miraton këtë kuadër nënligjor? Është VKM?

Elvana Ramaj – Po, është vendim i Këshillit të Ministrave.

Niko Peleshi – Atëherë, të thuhet: “me vendim të Këshillit të Ministrave”?

Elvana Ramaj – Po.

Niko Peleshi – Kush është dakord me nenin 15 të riformuluar: “... në përputhje me vendimin e Këshillit të Ministrave, që lidhet me miratimin e listave të tipave të habitateve natyrore, bimëve, kafshëve, shpendëve me interes të Komitetit European”. Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 16.

Nuk ka vërejtje.

Kush është dakord, sipas variantit të Këshillit të Ministrave? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 17.

Nuk ka vërejtje.

Kush është dakord, sipas variantit të Këshillit të Ministrave? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 18.

Nuk ka vërejtje.

Kush është dakord, sipas variantit të Këshillit të Ministrave? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 19.

Nuk ka vërejtje.

Kush është dakord? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 20.

Nuk ka vërejtje.

Kush është dakord? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Te neni 20?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Pas paragrafit II të shtohet paragrafi III?

Shikojeni në redaktim.

Ne jemi dakord, por nëse duhet zëvendësuar fjala “pikë” me fjalën “paragraf”, redaktojeni në përputhje me ligjin bazë.

Neni 21.

Kush është dakord? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Votojmë në tërësi.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ke të drejtë.

Neni 2.

Keni një referencë në nenin 45, që na duket e pasaktë, sepse neni 45 nuk ka referencë për agjencitë.

Elvana Ramaj – Unë kam një komunikim nga kolegët në zyrë. Fillimisht është menduar të hiqet neni 45, pasi mendohej se do të krijohet një strukturë kontrolli, që do të përmblihte të gjitha inspektoratet në fazën e draftimit të ligjit, si dhe Inspektoratin Shtetëror të Mjedisit të Pyjeve dhe të Ujërave, por në kushtet aktuale shprehem dakord të hiqet referenca.

Niko Peleshi – Hedhim në votim në parim neni 2.

Kush është dakord në parim, sipas Këshillit të Ministrave? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Pika 1 e nenit 2, me ndryshimin që fjalët “...përfshijë nenin 45”, të hiqen.

Kush është dakord? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Pika 2 e nenit 2, pa ndryshime. Kush është dakord? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Votojmë në tërësi nenin 2. Kush është dakord? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Mbaruam miratimin nen për nen.

Kalojmë në votimin në tërësi të projektligjit “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 10006, datë 23.10.2009 “Për mbrojtjen e Faunës së egër”, i ndryshuar”.

Kush është dakord? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Faleminderit!

Punë të mbarë!

MBYLLET MBLEDHJA